

## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### **Vendimi 2019-34**

**Data: 13.10.2019**

#### **Përkrahja e z. Fatos Bejta për certifikim si trajner kondicional**

Miratohet kërkesa e z. Fatos Bejta për përkrahje financiare për pjesëmarrje në Kursin Certifikues për Trajner Kondicional.

Bordi me shumicë votash merr vendim që z. Bejta të gëzojë përkrahje financiare për pjesëmarrje dhe certifikim, duke dhënë disa orë falas në këmbim për tenistët tanë. Kursi do të mbahet në Zagreb me gimnaziumin e njohur z. Marino Bashiq dhe do të zgjasë 7 ditë (2 ditë teori dhe 5 praktik).

### **Vendimi 2019-15K**

**Data: 15.10.2019**

#### **Pjesëmarrja e z. Shkelzen Domit në “Tennis Europe Juniors & Pro Conference”**

- Miratohet kërkesa e z. Domit për pjesëmarrje në cilësinë e organizatorit të garave në Konferencën “Tennis Europe Juniors & Pro Conference 2019”, i cili mbahet më 06-07 Nëntor në Milano.

- Z. Domi do të shkojë me shpenzime vetanake, por në rast se TM3 pranohet brenda këtij viti mund ti rimburesohet 50% e shpenzimeve.

### **Vendimi 2019-35**

**Data: 21.10.2019**

#### **Aprovimi i Rregullores për turnetë Masters**

-Aprovohet me shumicë votash Rregullorja për turnet Masters.

- Kjo rregullore hynë në fuqi më 18 Tetor 2019, dhe vlenë vetëm për turnet Masters.



**Vendimi 2019-36**

**Data: 23.10.2019**

**Aprovimi i Rregullave të Lojës për Mini-tennis**

-Aprovohen me shumicë votash Rregullat e Lojës për Mini-tennis, e hartuar enkas për ngjarjen “Mini-tennis Championships by BKT”, që pritet të mbahët më 26 Tetor 2019.

**Vendimi 2019-16K**

**Data:07.11.2019**

**Pjesëmarrja e z. Mërgime Mula në kursin ASMC2**

- Komiteti Olimpik i Kosovës këtë vit për herë të dytë organizon Kursin e Avancuar për Menaxhim Sportiv(ASMC2).

-Kryetari Rexhepi aprovon kërkesën që z. Mërgime Mula të merr pjesë në Kurs.

-Kursi përmban 8 module, dhe zgjatë afër 1 vit.